

ABSTRAKT

MARRËDHËNIET EKONOMIKE MIDIS SHQIPËRISË DHE ITALISË 1925-1936

Jorina VERLI

Qysh në dekadat e fundit të shekullit të XIX, pas krijimit të saj si shtet i unifikuar, Italia tregoi interes për t'u shtrirë në bregdetin lindor të Adriatikut. Me dëbimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani dhe me sigurimin, nga Fuqitë e Mëdha (në Konferencën e Londrës, e më pas në Konferencën e Parisit,) të rolit të saj të veçantë në Shqipëri, Italia filloi të hidhte hapa konkrete për shtrirjen e ndikimit të saj në të gjitha sferat e jetës së vendit. Nëse deri në vitin 1918 rivaliteti për ndikim në Shqipëri ishte midis Italisë dhe Austro-Hungarisë, në vitet 1925-1928, ky rivalitet shfaqet midis Italisë dhe Britanisë së Madhe. Sigurisht nuk duhen lënë mënjanë as ndikimet e aktorëve të tjerë të mëdhenj, si: Franca apo SHBA-ja dhe gjithashtu as të aktorëve të vegjël fqinjë të Shqipërisë, si: Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene dhe Greqia. Ahmet Zogu i rikthyer në pushtet pas revolucionit të qershorit të vitit 1924, arriti të finalizojë marrëveshjen e rëndësishme për krijimin e Bankës Kombëtare në vitin 1925. Gjithashtu të përfitonte disa hua të rëndësishme nga Italia për të vënë në lëvizje ekonominë e prapambetur të vendit. Në këtë vrull tratativash ekonomike me Italinë, shpaloset edhe synimi i saj i kahershëm për vendosjen e Shqipërisë nën protektorat, i cili sjell një acarim të dukshëm të marrëdhënieve midis dy shteteve në vitet 1933-1935. Në bazë të dokumentacionit të pasur shfaqet hapur synimi i vendit fqinj për të krijuar destabilitet politik dhe social në Shqipëri. Duke mos pasur rrugë tjetër përveç uljes së toneve me Italinë, A. Zogu ndryshoi edhe qeverisjen më 1936 duke sjellë në pushtet grupimin liberal të Mehdi Frashërit. Përpjekjet e Italisë kulmojnë në 7 prill 1939 me okupimin fashist të Shqipërisë në vazhden e shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore.

Fjalë kyçe: Republika shqiptare, monarkia shqiptare, Ahmet Zogu, Italia, marrëdhënie ekonomike.

ABSTRACT

THE ECONOMIC RELATIONS BETWEEN ALBANIA AND ITALY 1925-1936

Jorina VERLI

Since the last decades of the 19th century, after its establishment as a unified state, Italy showed interest in placing under its influence the countries located on the Eastern coast of the Adriatic. After the expulsion of the Ottoman Empire from the Balkans and after obtaining by the Great Powers (at the London Conference and then at the Paris Peace Conference) a special role in Albania, Italy began to take solid steps in order to extend its influence in all areas of life in Albania.

Until 1918 the rivalry for influence in Albania was between Italy and the Austro-Hungarian Empire. While in 1925–1928, this rivalry appeared to be between Italy and Great Britain. Of course, to be taken into consideration were also the influences of other major actors, such as: France or the US, and those of the small neighbor actors of Albania, such as: the Kingdom of the Serbs, Croats and Slovenes and Greece. Ahmet Zogu, who returned to power after the revolution of June 1924, managed to finalize the important agreement for the establishment of the National Bank of Albania in 1925. Also, he succeeded to obtain some important loans from Italy and put the country's underdeveloped economy in motion. In this rush of Albanian economic negotiations with Italy, unfolds Italy's early goal to place Albania under the protectorate. This effort brings a visible deterioration of relations between the two states especially in the period 1933-1935. Under the light of the rich historiographical documentation, the intention of the neighbor country to create political and social instability in Albania is openly displayed. Having no other option but to lower the tones with Italy, A. Zogu also changed the government by bringing to power the liberal group of Mehdi Frashëri. Italy's

efforts culminate on the 7th of April 1939 with the fascist occupation of Albania in the midst of the outbreak of World War II.

Keywords: Albanian Republic, Albanian Monarchy, Ahmet Zogu, Italy, economic relations.

Struktura dhe përmbajtja e punimit

Shkurtimisht, paraqitet më poshtë struktura e temës “*Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Italisë në vitet 1925-1936*”:

Tema starton me një kapitull të parë, i cili titullohet “Interesimi dhe përpjekjet e Italisë për të kontrolluar ekonominë shqiptare deri në vitin 1924”. Në të bëhet një parantezë e zhvillimeve të viteve 1925-1936, ku vlen të theksohen: rritja e interesit të Italisë për ekonominë shqiptare gjatë shekullit të XIX deri në vitin 1912; roli i veçantë që kërkoi dhe siguroi Roma krahas Austro-Hungarisë nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Londrës së 1912-1913; shfaqja e interesave ekonomike e politike të saj në vitet 1913-1918; konfirmimi ndërkombëtar i njohjes speciale të përparësive italiane në Shqipëri, nga Konferenca e Paqes në Paris në vitet 1919-1920 këtë herë pa konkurrentë etj. Kapitulli i parë mbyllet me trajtimin e përpjekjeve të Italisë për dominim politik dhe ekonomik në Shqipëri në vitet 1920-1924 dhe pasojat e tyre për shtetin shqiptar.

Kapitulli i dytë ka për objekt “Konkurrencën e Italisë me Britaninë e Madhe dhe me fuqi të tjera për të siguruar konçesione në Shqipëri (1925-1928)”. Këtu trajtohen përplasjet e monopoleve të mëdha angleze, amerikane, franceze dhe italiane, për të dominuar në konçesionet për naftën shqiptare, përplasje që arritën kulmin menjëherë pas rikthimit të A. Zogut në pushtet në dhjetorin e vitit 1924. Po në kuadër të raporteve shqiptaro-italiane të kësaj kohe, trajtohen edhe zhvillimet politike në fusha të tjera, veçanërisht në krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare. Gjithashtu, trajtohen në mënyrë sintetike dy Paktet politike të Tiranës të viteve 1926 dhe 1927, të cilat ishin pjesë e strategjisë së Romës për të dominuar në Shqipëri në çdo aspekt të jetës së vendit.

Në kapitullin e tretë të dhënat historike plotësohen me një vështrim të detajuar mbi “Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-italiane në vitet 1928-1933, si reflektim i luhatjeve në raportet politike midis dy vendeve”. Në këtë kapitull në pjesë të veçanta trajtohen treguesit

ekonomikë të Shqipërisë pas vitit 1928 sipas degëve kryesore, mandej reformat e A. Zogut dhe qëndrimi i Italisë, i cili ishte shkaku i tensionimit të marrëdhënieve shqiptaro-italiane. Ato u reflektuan edhe në veprimet e Romës për të penguar konkretisht zhvillimet ekonomike dhe për të nxitur lëvizje politiko-sociale destabilizuese në vitet 1931-1932.

Paralelisht, në këtë kapitull jepet informacion se, edhe në kushtet e thellimit të krizës ekonomike të viteve 1929-1933, në Shqipëri u vunë në jetë një varg reformash në fushën legislative, të marrëdhënieve agrare, të komuniteteve fetare, të rregullimeve administrative, të ruajtjes së rendit etj., të cilat i shërbyen konsolidimit të shtetit shqiptar.

Kapitulli i katërt është një nga pjesët më interesante të temës dhe titullohet “Acarimi i marrëdhënieve shqiptaro-italiane në vitet 1933-1935”. Së pari, aty trajtohet reflektimi i konfliktit politik midis dy vendeve në marrëdhëniet ekonomike gjatë periudhës 1933-1935. Një nënçështje tjetër ka për objekt situatën në Shqipëri dhe tentativat e A. Zogut për të përballuar tensionin italian në këto vite. Me këtë rast sqarohet roli i Italisë në rebelimin e vitit 1935, që njihet si “kryengritja e Fierit”.

Kapitulli i pestë dhe i fundit titullohet “Impakti ekonomik i përmirësimit të marrëdhënieve politike midis dy vendeve në vitin 1936”. Fillimisht në këtë kapitull kam trajtuar situatën ndërkombëtare në vitet pas Depresionit të Madh, e cila karakterizohet nga shtimi i ekspansionit të bllokut fashist. Më tej, vështrimi ndalet në situatën e brendshme në Shqipëri. Me këtë rast analizohen hapat e ndërmarra nga A. Zogu për kapërcimin e krizës së brendshme dhe të jashtme, duke liberalizuar stilin e qeverisjes, përmes mandatimit të një qeverie të re “liberale” me në krye Mehdi Frashërin. Trajtim të posaçëm kanë marrëveshjet italo-shqiptare të marsit 1936, që u realizuan nga kjo qeveri, duke ulur tensionin midis dy vendeve, por që rritën më tej dominimin italian në Shqipëri. Së fundi, nuk mungon edhe trajtimi i shkaqeve të largimit të Mbretit nga kursi liberal i qeverisjes. Në 7 nëntor 1936, për shkak të situatës sociale të paqëndrueshme në Shqipëri, por edhe për arsye të tjera të natyrës diplomatike, që synonin përballimin e situatës ndërkombëtare, e cila po evoluonte me shpejtësi, kabineti i Mehdi Frashërit u rrëzua për t’iu lënë vendin konservatorëve në qeverisje. Një trajtim i veçantë në këtë kapitull i bëhet edhe bilancit të raporteve ekonomike shqiptaro-italiane në gjithë periudhën e viteve 1925-1936.

Pesë kapitujt pasohen nga mbyllja dhe përfundimet. Te pjesa e mbylljes, e cila mund të konsiderohet edhe si një “pashënie” hidhet një vështrim konçiz ekonomik-politik mbi

marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet e fundit (1937-1939) përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Aty paraqiten të dhëna kuantitative të cilat tregojnë konkretisht nivelin e dominimit italian në ekonominë e Shqipërisë, raportet e kapitalit të huaj me kapitalin vendas dhe avancimin e përgjithshëm të degëve të ekonomisë krahasuar me vitet e para pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore.

Tek sythi i përfundimeve vihet nën lupë e gjithë tema e trajtuar. Aty parashtrohen rezultatet e nxjerra nga punimi dhe bëhet zbërthimi dhe ballafaqimi i tyre me idetë e hedhura tek hipotezat. Hipotezat e përmendura në hyrje kanë shërbyer si shina mbi të cilat është realizuar i gjithë hulumtimi dhe do të vlejnjë edhe për studime të tjera, që planifikoj të kryej në të ardhmen mbi aspekte më specifike të kësaj teme, siç janë: çështja e Bankës Kombëtare, gjendja ekonomike e Shqipërisë gjatë periudhës së qeverisjes së Nolit etj.

Paraqitje e përgjithshme e temës dhe burimet e shfryëzuara për shkrimin e saj

Periudha rreth 20 vjeçare, midis dy Luftërave Botërore, është një periudhë e mbushur me ngjarje e zhvillime të shumëllojshme, si në planin ndërkombëtar, ashtu edhe në planin rajonal e kombëtar. Në këtë kohë, shteti shqiptar i asgjësuar menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe njohjes ndërkombëtare, për shkak të Luftës së Parë Botërore dhe prishjes së konsensusit të Fuqive të Mëdha, u ringrit, u pranua ndërkombëtarisht, u konsolidua dhe hodhi hapa drejt emancipimit dhe demokratizimit. Natyrisht, progresi përfshiu të gjitha sferat e jetës, që nga arsimit e kultura deri tek legjislacioni, ngritja e institucioneve dhe ekonomia.

Në segmente të caktuara kohore, gjatë periudhës së sipërpërmendur, pati përparësi të ndryshme, ritme të ndryshme zhvillimi, përplasje politike të intensiteteve të ndryshme, të cilat u kushtëzuan nga ecuritë e faktorit të brendshëm, e ndoshta më shumë, të faktorit ndërkombëtar.

Gjatë studimit të vazhdueshëm të literaturës historiografike për periudhën 1925-1936 jam intriguar gjithmonë nga përfundimet që kanë nxjerrë autorët vendas dhe të huaj, nga kundërshtitë që ata kanë pasur midis tyre, si edhe nga qëndrimet e ndryshme të mbajtura nga historiografia e huaj. Duke pasur një formim universitar e pasuniversitar ndërdisiplinor, (kam përfunduar studime bachelor dhe master në fushën e ekonomisë, e më pas studime master në fushën e

historisë,) kam pasur prirjen që gjatë hulumtimeve të mia, materialet që shqyrtoja, t'i analizoja sa nga aspekti historik, aq edhe nga ai ekonomiko-financiar.

Aftësia për t'i trajtuar të njëjtat të dhëna sipas qasjeve të ndryshme analitike, në rradhë të parë nga pozita e historianit, e së dyti edhe nga pozita e ekonomistit, mendoj se përbën një avantazh dhe një risi, e cila nuk gjendet te studiuesit me formim monodisiplinor dhe përbën një vlerë të shtuar në morinë e punimeve që mbulojnë periudhën.

Shumica e këtyre punimeve ekzistuese kanë në fokus marrëdhëniet diplomatike midis dy vende dhe pasqyrimin e tyre në aspektin politiko-social, ndërkohë që marrëdhëniet ekonomike, të cilat qëndrojnë realisht në themel të të gjitha zhvillimeve të tjera, mbeten disi në hije dhe janë më pak të trajtuara. Në këtë qasje analitike pak të lëvruar deri më sot, ku ndërthurret historia diplomatike dhe historia e ekonomisë, mendoj se gjendet kontributi im origjinal në hulumtimet e periudhës dhe motivi që më ka shtyrë të kryej këtë kërkim dhe ta zhvilloj më pas në nivelin e një teze doktrate.

Ky punim është bazuar (krahas materialeve ekzistuese,) në një mori dokumentesh të reja arkivore dhe botimesh kolektive dhe monografike të viteve të fundit, duke vendosur kështu në një kontekst më të pasur informativ ngjarjet më të spikatura të periudhës së Republikës dhe Monarkisë shqiptare.

Pasurimi me dokumente të reja i Arkivit të Institutit të Historisë, nga kancelaritë e vendeve më të interesuara ndaj Shqipërisë e rajonit, më dha nxitjen që të zgjedh pikërisht periudhën e viteve 1925-1936 dhe të ndërmarr sprovën e një punimi doktrate, i cili titullohet “Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Italisë në vitet 1925-1936”.

Përballë punimeve të tilla madhore akademike, si: “Historia e Shqipërisë”, botuar në disa edicione gjatë viteve 1960-1980; “Historia e Popullit Shqiptar” botuar në vitet 2002-2008, në katër vëllime; “Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX”, botuar në vitet 2017-2023, në pesë vëllime; studimeve monografike të profesorëve të mirënjohur: *Arben Puto, Muin Çami, Viron Koka, Paskal Milo, Iljaz Fishta, Gazmend Shpuza* etj., që trajtojnë posaçërisht situatën politike të viteve 1920-1930; studimeve e botimeve të autorëve të tjerë, si: *Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Valentina Duka, Kaliopi Naska, Iliaz Gogaj, Marenglen Verli, Pranvera Teli-Dibra, Ilir Ushtelenca, Arben Cici, Aurela Anastasi, Emine Arifi (Bakalli), Izber Hoti, Fatmira Musaj, Mentor Hasani, Armend Mehmeti, Albana Mema* etj., që i qasen problemeve të ndryshme më

specifike të kësaj periudhe; autorëve më të hershëm, si: *Teki Selenica, Sejfi Vllamasi* etj.; autorëve të huaj, si: *Bernd J. Fischer, Noel Malcolm, Joseph Swire, Vuk Vinaver, Pietro Pastorelli, Natalie Clayer, Haris Silajdžić, Georges Castellan, Robert Austin, Owen Pearson, Bogumil Hrabak, Zhivko Avramovski* etj., është e vështirë edhe vetëm të tentosh të shkruash.

Megjithatë, këndvështrimi i temës, i cili gërsheton situatën ekonomike me atë politike, më ka krijuar hapësirën e nevojshme dhe gjetjen e zonave jo fort të eksploruara. Kam besuar se duke analizuar metodën e punës në vlerësimin e fakteve dhe argumentat e autorëve të nderuar të sipërpërmendur, si edhe duke shfrytëzuar botimet dokumentare e memoaret e botuara ndërkohë, veçanërisht në dy dekadat e fundit, dhe sidomos materialin arkivor ende të paprekur të depozituar në Institutin e Historisë, (veçanërisht dokumentacionin italian dhe atë britanik e amerikan,) do të mund të sjell qoftë analiza nga këndvështrimi im, qoftë edhe të dhëna të reja faktografike.

Mjaft hezitim kam patur për të përcaktuar temën dhe segmentin kohor në të cilin do të duhej të kufizohesha, për të qenë në harmoni me kërkesat institucionale që vlejné për një temë të kësaj kategorie.

Tema “Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Italisë në vitet 1925-1936”, qoftë si përmbajtje, qoftë si etapë kohore, m’u duk me interes të veçantë. Janë vite me zhvillime kulmore ekstreme në marrëdhëniet midis dy vendeve, me impakt në politikën bilaterale e më gjerë, veçanërisht në ekonomi, por edhe në arsim, në gjendjen shoqërore etj.

Është koha e “ngrohjes” dhe “ftohjes” politike midis Romës dhe Tiranës, e presioneve maksimale për të ndryshuar raportet midis dy vendeve në favor të Italisë e në dëm të Shqipërisë, e ofrimit dhe më pas ndërprerjes së financimit përmes kredive, e konçesioneve të burimeve ekonomike të vendit, përballë presionesh të ndërthurrura politike, e ngritjes së Bankës Kombëtare të Shqipërisë me kapital të huaj dhe me rol të diskutueshëm për interesat e shqiptarëve etj. Është gjithashtu koha e dërgimit dhe më pas e tërheqjes së specialistëve të huaj, e demonstrimit të hapur të forcës nga Italia e Mussolini-t, por edhe e kundërpërgjigjes së fortë të Mbretit Zog I, që me sa duket siguroi disi përkrahjen e Britanisë së Madhe dhe pati mirëkuptimin e Francës.

Megjithatë, arsye madhore të tilla, si:

- kriza ekonomike botërore e viteve 1929-1933, (që në Shqipëri do të zgjaste deri në vitin 1935,)

- mungesa e një mbështetjeje efektive rajonale, (sidomos nga fqinjët tokësorë ballkanikë,)
- dhe hapja e dritës jeshile për ekspansionin italian drejt bregut lindor të Adriatikut nga ana e Fuqive të Mëdha, (në kuadër të rivlerësimeve gjeostrategjike të diplomacive botërore,) përcaktuan riafrimin e Tiranës me Romën në vitin 1936.

“Goditjet” italiane të natyrës politike, (si: demonstrata navale e qershorit 1934, apo rebelimi i Fierit i gushtit 1935) dhe përballjet e vazhdueshme në fushën ekonomike, (si: bllokada ekonomike deri në asfiksi gjatë gjysmës së parë të viteve 1930, apo ultimatimet e Mussolini-t të refuzuara kokëfortësisht njëri pas tjetrit nga Mbreti Zog), besoj kanë dalë sipas një këndvështrimi interesant, falë edhe materialit të ri arkivor që kam patur mundësinë të shqyrtoj. Qëndrimet e Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë po ashtu.

Ndryshimet e kursit nga Britania e Madhe dhe Franca dhe interesat e tyre ekonomike në Shqipëri janë trajtuar në përmasën sa mund të pranonte një temë e këtij niveli. Por, paralelisht, i kam kushtuar vëmendje të veçantë lëvizjeve të brendshme të A. Zogut. Në këtë kuadër, ai, për të ngritur ekonominë, për të siguruar kreditimin nga jashtë (jetik për konsolidimin e shtetit), për të bërë politikë edhe përmes pranimin të studiuar të kërkesave për konçesione, solli për gati dy vjet në pushtet një qeveri (siç u quajt) “liberale”, nën kryesinë e Mehdi Frashërit. Kjo qeveri ndër të tjera, shërbeu për të zhbllokuar krizën në marrëdhëniet me Italinë që i kishte marrë frymën ekonomisë shqiptare.

Ka shumë intrigë, shumë aksion, shumë diplomaci, shumë manovra, shumë spekulime dhe shumë *bluff*-e gjatë këtyre viteve dhe që janë trajtuar në këtë studim. Thurret pra, me shumë vrull, një rrjetë e tërë veprimesh e kundërveprimesh, politike dhe ekonomike, nga dy partnerë me synime të kundërta, ku njëri kërkonte të diktonte gjithçka, duke menduar në perspektivë aneksimin, ndërsa tjetri kërkonte t’i shpëtonte morsës së hekurt, që mund të çonte në protektorat e që shtrëngohej çdo ditë e më shumë.

Metodologjia e ndjekur në hulumtim dhe hartimi i hipotezave

Sa i përket metodologjisë së kërkimit, për hartimin e këtij punimi është përdorur dhe zbatuar metoda historike ose thënë ndryshe, *metoda e hulumtimit retrospektiv*, për t’i ofruar lexuesit një imazh të kthjellët mbi çështjet dhe problematikat kryesore që e karakterizojnë periudhën. Në tekst do të paraqiten pikëpamjet dhe kontributi i autorëve të mëparshëm, i cili do

të vihet përballë hipotezave shkencore, analizës dhe qëndrimit tim pas shqyrtimit të dokumenteve të reja arkivore.

Për analizën e të dhënave dhe shifrave është përdorur *metoda e përzier*, pra si *metoda cilësore (kualitative)* ashtu dhe ajo *sasiore (kuantitative)*. Zgjedhja e kësaj mënyre hulumtimi nuk është kryer *a priori*, por ka lindur si domosdoshmëri, referuar natyrës shifrore të të dhënave të mbledhura dhe konsultuara për studimin konkret.

Përpara fillimit të këtyre studimeve dhe hulumtimeve kam parë të udhës të ngre edhe një sërë hipotezash, të cilat kanë shërbyer si themele mbi të cilat të ndërtoj kërkimin tim. Po shënojmë këtu disa prej tyre:

- A. Duhet të fajësohet politika e jashtme e A. Zogut për orientimin tërësor drejt Italisë sidomos gjatë gjysmës së dytë të viteve 1930. Shqipëria kishte mundësi të krijonte aleancë njësoj të fuqishme edhe me Britaninë e Madhe.
- B. Italia e përgatiti terrenin për ndërhyrje në Shqipëri më me kujdes dhe më me këmbëngulje se të gjithë të interesuarit e tjerë.
- C. Italia donte të ishte, qysh në fillim të viteve 1920, pjesëmarrëse me investime serioze në Shqipëri, por e pati të pamundur për shkak të reputacionit jo të mirë që zotëronte ndër shqiptarët.
- D. Përveç fuqisë ekonomike, kishte edhe arsye të tjera që e shtynë A. Zogun të orientohej nga Italia dhe jo nga Jugosllavia, pas rikthimit në pushtet në vitin 1925.
- E. Tërheqja graduale e Britanisë së Madhe nga ndikimi në Shqipëri ishte shkak i politikës së saj të brendshme dhe jo pasojë e fuqizimit dhe këmbënguljes italiane.
- F. Pavarësisht nga synimet koloniale italiane, kreditimi i ekonomisë në Shqipëri ishte jetik për Shqipërinë, me rezultate veçanërisht pozitive në infrastrukturën rrugore, urbanistikë, ndërtime, teknologji etj.
- G. Investimet italiane nuk synuan vetëm degë të ekonomisë me vlera apo rentabilitet ekonomiko-financiar, por mbi të gjitha me rëndësi strategjike.

Burimet e reja të dala rishtaz në dritë, evoluimi i proceseve kërkimore-shkencore dhe konceptet e reja në historiografi, kanë vlejtur si një skaner për përfundimet e nxjerra më herët dhe kanë dhënë një përfytyrim më objektiv dhe më të saktë për ngjarjet.

Zhvillimet politike dhe personazhet historike janë analizuar në kontekstin e kohës kur jetuan dhe vepruan, por gjithashtu janë trajtuar edhe të abstraguar nga konteksti, në gjykimin e paanshëm të pakohësisë.

Për shkak të informacioneve të reja dhe konceptimit të ri të historisë shqiptare, ky studim synon të sjellë risi, si për nga mënyra e trajtimit, ashtu edhe për nga përmbajtja, ndaj qëndroj shpresëplotë se do të përbëjë vlerë në morinë e punimeve hulumtuese të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, por edhe më gjerë.

Përfundime dhe vërtetimi i hipotezave

Nga materiali i paraqitur në këtë punim, duke përfshirë edhe periudhën para vitit 1925, konstatohen dy periudha të mëdha, qoftë në veprimtarinë e Italisë për të depërtuar politikisht dhe ekonomikisht në Shqipëri, qoftë për rezultatet që ajo arriti. Kufiri i këtyre dy periudhave është viti 1925.

Në periudhën e parë, që fillon me krijimin e shtetit të bashkuar italian e vazhdon përtej vitit 1912, Italia kishte vetëm Perandorinë Austro-Hungareze si konkurrenente serioze për të depërtuar në viset shqiptare. Shqipëria bënte pjesë në Perandorinë Osmane, e cila prej disa dekadash shkonte drejt rënies dhe asgjësimit, pavarësisht nga interesi i disa Fuqive të Mëdha, si Britania e Madhe dhe Franca për t'i zgjatur jetën asaj. Në kufi me dy shtete të fuqishme, Francën dhe Austro-Hungarinë, Italia e shihte të mundshëm depërtimin e saj në Europë vetëm në drejtim të bregdetit shqiptar, përmes Adriatikut dhe Jonit.

Njohësit e politikës koloniale italiane, në përgjithësi, vërejnë që me ndonjë përjashtim, synimet e saj edhe në bregdetin verior të Afrikës, përkatësisht në Libi, në ishujt e Detit Egje dhe përgjithësisht në Mesdheut lindor, programonin të vinin nën kontroll pikërisht territore të Perandorisë Osmane.

Politika e Romës, në krye të së cilës ishte edhe ndonjë arbëresh në periudha të caktuara, si Francesco Crispi (Françesko Krispi), u përpoq të shtojë influencën në bregdetin shqiptar, të konkurrojë sa të ishte e mundur influencën austro-hungareze në zonat katolike të veriut, të shtrijë nëpërmjet një politike të veçantë ndaj komunitetit mysliman shqiptar, influencën edhe në zona të tjera dhe të fuqizojë gradualisht një lob proitalian në viset shqiptare.

Në dekadën e fundit të sundimit osman në Ballkan, rrjedhimisht edhe në Vilajetet shqiptare, konstatohet se midis të dy fuqive të Adriatikut ishte vendosur një ekuilibër në Durrës, i ishte lënë supremacia Austro-Hungarisë në Shkodër, por nga Italia ishte marrë avantazhi në Vlorë. Pikërisht mbi bazën e këtyre interesave dypalëshe, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Fuqitë e Mëdha, ku bënte tashmë pjesë edhe Italia, i njohën Vjenës dhe Romës një kujdestari të veçantë mbi shtetin shqiptar të porsakrijuar.

Dokumentacioni i kohës nxjerr në pah se në procesin e punës së kësaj Konference, Italia vinte pas Austro-Hungarisë, me qëndrime pozitive për çështjen thelbësore shqiptare, pra për ngritjen e një shteti shqiptar të pavarur dhe me kufij që do të mundësonin konsolidimin dhe jetëgjatësinë e tij. Gjithsesi, këto dy rivale e patën jetik bashkëpunimin në këtë periudhë, por që nuk do të zgjaste në kohë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, ushtritë pushtuese austro-hungareze dhe italiane që tani ishin përballë njëra-tjetrës, pjesë e dy koalicioneve të kundërta, e kishin vijën e frontit në rrjedhën e poshtme të lumit Vjosa.

Konferenca e Paqes e viteve 1919-1920 që u mbajt në Paris, pasi Perandoria Habsburge u shpërbë dhe nuk bëhej fjalë më për pretendime në këtë rajon të Adriatikut, i njohu një pozitë të veçantë Italisë. Tashmë nuk ishte më fjala për një konkurrencë dypalëshe si dikur, por vetëm për depërtimin italian duke shmangur një rivalitet fare të dobët nga shteti serbo-kroato-sllloven (i quajtur zyrtarisht Mbretëri e Jugosllavisë në vitin 1929), që u krijua nga territoret e ish-perandorisë austro-hungareze dhe nga pjesa veriore dhe lindore e viseve shqiptare të Perandorisë së dikurshme Osmane. Në vitin 1921 “kujdestaria” italiane ndaj Shqipërisë ishte sanksionuar ndërkombëtarisht.

Këto argumente vërtetojnë **hipotezën B**, në të cilën thuhet se Italia e përgatiti terrenin e ndërhyrjes së saj në Shqipëri me më shumë këmbëngulje se të gjithë të interesuarit e tjerë. Për Italinë rëndësia e dominimit politik dhe ekonomik në Shqipëri i kishte rrënjët në faktin që ajo shihte këtu të vetmen portë për depërtimin në Europën juglindore. Në bregun perëndimor të gadishullit Ballkanik, jugu (Greqia) ishte zonë e padiskutueshme e ndikimit britanik, kurse veriu (Jugosllavia) ishte zonë e ndikimit francez.

Gjithsesi, gjatë periudhës së paqes pas Luftës së Parë Botërore deri në vitin 1925, politika italiane dhe depërtimi ekonomik përmes investimeve, tregtisë etj., nuk ishte në përpjesëtim me energjitë italiane për të qenë e pranishme në territoret shqiptare. Shqiptarët, pasi i kishin besuar politikës së Romës gjatë zhvillimit të Konferencës së Paqes, kishin konstatuar, me të drejtë, se në

kuadër të politikës rajonale italiane, shteti shqiptar shkonte drejt asgjësimit. Prandaj, pavarësisht lobit tashmë të konsiderueshëm italian në Shqipëri, Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës që pasoi, e bënë Italinë në sytë e elitës politike kombëtare shqiptare, por edhe të shumicës së popullsisë, të papëlqyeshme, për të mos thenë të urryer. Këtu vërtetohet **hipoteza C**.

Kështu që, në drejtim të konçesioneve, që janë treguesi parësor për t'i krijuar avantazhe një shteti në territorin e një shteti tjetër, italianët nuk arritën të sigurojnë asgjë me rëndësi. Ndërkohë që në Parlamentin shqiptar flitej rregullisht për mbështetjen te Britania e Madhe apo te SHBA-ja, për shembull kur ishte rasti për konçesionin e naftës, madje edhe ata që dihet se nën zë ishin pjesë e lobit italian, qëndronin në mbrojtje të interesave të shoqërisë amerikane dhe nuk flisnin për interesat italiane.

Gjithsesi Italia, përveç elitës politike dhe ekonomike të disa viseve të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, kishte bërë për vete edhe elitën politike të shqiptarëve të Kosovës, e cila ishte bërë pjesë e elitës politike të Shqipërisë, pasi u largua nga vendlindja e saj dhe duke u instalua në Shqipëri. Kjo elitë, duke arsyetuar globalisht, mendonte se Kosova mund të rifitohej vetëm me ndihmën e Italisë, pa llogaritur riskun që do të vinte nga një qëndrim i tillë.

Në vitin 1925, fillon një periudhë e dytë për marrëdhëniet shqiptaro-italiane. Grupimi politik me në krye A. Zogun, që vendosi pushtetin e “dorës së fortë” në Shqipëri dhe detyroi eksponentët kryesorë të opozitës të emigrojnë, përpara alternativave të mbështetjes ose te Jugosllavia ose te Italia, zgjodhi opsionin e dytë.

A. Zogu për t'u rikthyer në pushtet në dhjetor 1924, përveç ndihmës së hapur jugosllave, kishte siguruar në hije edhe mbështetjen italiane. Për të zgjedhur midis dy alternativave në forcimin e lidhjeve, sigurisht në Tiranë do të preferohej një shtet që nuk kishte kufij tokësorë, një shtet që kishte fuqi ekonomike të konsiderueshme, për të injektuar kapitale financiare dhe *know-how* në ekonominë e rrënuar të vendit, një shtet që do të mund të frenohej duke luajtur njëherësh me interesat britanike në rajon dhe në gjithë Mesdheun, një shtet që do t'i hidhte me shumë kujdes hapat që shkonin në dëm të Shqipërisë për shkak të hipotekës negative që vinte nga viti 1920. Këtu vërtetohet **hipoteza D**.

Kështu që, duke filluar nga 1925 e në vazhdim, Italia ishte partneri i parë i Shqipërisë qoftë në aspektin politik, qoftë në atë ekonomik. Kriza e jashtëzakonshme ekonomike, në kuadër të Depresionit të Madh, në të cilën hyri edhe Shqipëria, keqësimi në momente të caktuara i marrëdhënieve me fqinjët tokësorë, veçanërisht me Jugosllavinë dhe tërheqja graduale e

Britanisë për shkak të ndryshimeve në politikën e saj globale, bëjnë që depërtimi italian të vijë duke u rritur. Këtu vërtetohet **hipoteza E** dhe rrëzohet (bie poshtë) **hipoteza A**.

Gjatë viteve 1930, nëpërmjet Bankës Kombëtare Shqiptare, Banco di Napoli, AIPA në naftë, SIGMA në qymyrguri, SIMSA dhe SAMIA në kërkim-shfrytëzimin e bakrit, AMMI në krom dhe minerale të tjera, Pescalba në peshkim në ujëra të brendshme dhe në ujëra të jashtme, SEIA dhe bijës së saj SESA në industrinë elektrike, SCAIA në industrinë e materialeve të ndërtimit, Staccioli-t në prodhimin e tullave dhe tjegullave, EIAA në sektorin e bujqësisë, investimeve në sektorin e tregtisë me shumicë dhe lundrimit etj., Italia ishte në mënyrë të padiskutueshme investitorja kryesore e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe lider në shumë nga degët ku ajo investoi, madje edhe përballë kapitalit vendas. Këtu vërtetohet **hipoteza F**.

Në sektorin e naftës, për shembull, kostoja e prodhimit, pra e investimit, ishte më e lartë se kudo në rajon, megjithatë për qëllime strategjike, Italia vendosi të investojë. Gjithashtu, nuk vihet re marrja nën kontroll e degëve me rentabilitet të mirë fitimi, si: industria e lehtë, ushqimore etj. Këto degë zotërohen kryesisht nga sipërmarrësit shqiptarë. Në përmbyllje të këtij arsytimi vërtetohet **hipoteza G**.

Konstatohet kështu se periudha midis dy Luftërave Botërore, pavarësisht nga startimi i dobët, pavarësisht nga problemi i mbartur i katastrofës që i solli kombit shqiptar copëtimi i territoreve dhe, edhe pse u ndodh për shumë vjet nën pasojat e krizës që solli “Depresioni i Madh”, kishte një ngritje ekonomike.

Ngritja u vërejt veçanërisht në degë të ekonomisë të panjohura në fillim të shekullit, si: industria minerare, transporti automobilistik etj.

Investimi i kapitalit të huaj, veçanërisht atij italian, pavarësisht nga synimet politike të Italisë, ndikoi në zhvillimin e ekonomisë, të infrastrukturës rrugore, në rinovimin arkitekturor të qendrave të qyteteve kryesore, në implementimin e teknologjisë dhe makinerive të reja në degë të ndryshme të prodhimit etj. Këto arritje nuk mund të realizoheshin vetëm përmes kapitalit vendas. Natyrisht, kostoja që pagoi Shqipëria ishte e lartë, për sasinë e kapitalit italian që u investua, sikurse u trajtua në këtë punim, qoftë në aspektin ekonomik, qoftë në atë politik. Po a pati alternativa të tjera? Përgjigjja është jo.

Një pashënie e shkurtër

Sipas një vjetari statistikor të botuar në Milano në vitin 1940, në bazë të studimeve që kishin kryer në vitet e mëparshme në territorin shqiptar, konçesionarët e huaj rezultojnë të kishin zbuluar këto rezerva: 20 milionë tonë mineral hekuri, 5 milionë tonë mineral bakri, 500 mijë tonë mineral kromi etj.¹ Këto rezerva, si edhe ato të naftës, që ishin të konsiderueshme, krijuan premisa për zhvillimin e industrisë nxjerrëse minerare.

Për të dhënë një bilanc sa më të qartë lidhur me konçesionet në fushën e kërkim-shfrytëzimit të naftës dhe të mineraleve të tjera, duhet të theksohet se shoqëritë britanike, franceze, amerikane dhe veçanërisht ato italiane, si dhe një numër investitorësh më të vegjël nga vendet e tjera, kishin siguruar deri në vitin 1938, 79 konçesione për kërkim-shfrytëzimin e pasurive të nëntokës shqiptare.²

Veçanërisht në industrinë e nxjerrjes së naftës u investuan kapitale të shumta. Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, domethënë deri në vitin 1938, kapitali i investuar prej shoqërisë italiane AIPA kapi shifrën e 100 milionë frangave ari. Ky investim i kalonte 4 herë e gjysëm të gjitha kapitalet e investuara në industrinë kombëtare nga investitorët vendas.

Deri në prag të pushtimit italian të Shqipërisë, AIPA kishte hapur rreth 480 puse produktive duke përdorur sondat elektrike me kulla, që ishin një teknologji bashkëkohore për nxjerrjen e naftës. Në shërbim të tyre u ndërtua një central elektrik me 2.400 kuaj fuqi, ndërsa tubacioni transportues nga Kuçova deri në Vlorë arriti në 74 km gjatësi.

Veçanërisht në periudhën e fundit, kur Italia kishte siguruar tolerancë maksimale nga qeveria shqiptare, domethënë pas vitit 1936, prodhimi i naftës u rrit shumë shpejt. Nga 12.000 tonë që nxirreshin në vitin 1935, në vitin 1938 u prodhuan 127.000 tonë.³

Mbas një krize dy-tre vjeçare në marrëdhëniet shqiptaro-italiane dhe dështimit të politikës së qeverisë së Tiranës për të gjetur një aleancë të re shumëplanëshe, pas vitit 1936, Italia nuk kishte më rivalë për të vepruar në përputhje me interesat e saj të dëpërtimit në Shqipëri

¹ *Annuario del Regno d' Albania*, Milano: Casa editrice Ravagnati, Tipografia A. Cordani, 1940, f. 73.

² Ferdinando di Fenizio, *Giornale degli economisti*, Padova: 1940, f. 114-115.

³ *Il petrolio italiano in Albania (AIPA)*, 1939, f. 8; *Anuari Statistikor i Republikës Popullore të Shqipërisë 1959...*, f. 74. Sipas tij prodhimi i naftës bruto në vitin 1938 ishte 108.116 tonë. Shënoj se të dhënat ndryshojnë nga njëri burim në tjetrin. Llogaritjet nuk përputhen edhe kur veprimet bëhen mbi bazën e numrit të fuçive dhe të galonave sipas masës britanike (1 galon = 4,54 litra), ose masës amerikane (1 galon = 3,781 litra). Në këtë rast për vitin 1938, prodhimi ishte 142.128 tonë (brit.) ose 119.417 (US.). Kurse në vitin 1935, përkatësisht 7.749 tonë ose 6.510 tonë.

dhe në rajon. Pas rënies së qeverisë së Stojadinović-it në Jugosllavi, Italia u ndje në pozicionin më të favorshëm për ta aneksuar pa bashkëpjesëmarrës të gjithë Mbretërinë shqiptare, çka edhe u krye me agresionin e 7 prillit 1939.

Degët e industrisë	Kapitali i investuar në %			Prodhimi industrial i vendit në %	Numri i punëtorëve të industrisë	Numri i punëtorëve sipas degëve të industrisë në %	Numri i njësive industriale
	Gjithsej kapitali i investuar për vendin në %	Nga ky:					
		Kapitali shqiptar në %	Kapitali italian dhe italo-shqiptar në %				
Industria gjithsej	100	15,14	84,86	100	7.255	100	432
1. Industria minerare	81,54	0,4	81,14		2.500	34,46	5
2. Industria elektrike, përpunimi i metaleve, materialet e ndërtimit, përpunimi i drurit	7,17	6,99	0,18		2.628	36,22	
3. Industria e lehtë	3,93	3,9	0,03	28,7	1.546	21,3	
4. Industria ushqimore	8,22	6,65	1,57	43,8	1.448	19,7	

Tab. - Kapitali i investuar, prodhimi, numri i punëtorëve dhe numri i njësive industriale në vitin 1938

Siç shihet edhe nga tabela, kapitali shqiptar në fund të periudhës zotëronte vetëm 15,14% të investimeve në industri, kundrejt 84,86% të kapitalit italian, sporadikisht në bashkëveprim edhe me kapitalin shqiptar. Për të njëjtën periudhë, numri i punëtorëve të industrisë kishte arritur në 7.255 vetë dhe numëroheshin gjithsej 432 njësi industriale. Në strukturë, ku llogariten degët ku investoheshin kapitalet në industri, industria minerare zinte 81,54% të totalit, kundrejt industrisë së lehtë që zinte 3,93%, industrisë ushqimore që zinte 8,22% dhe industrisë elektrike, përpunimit të metaleve, materialeve të ndërtimit dhe përpunimit të drurit, të cilat zinin 7,17% të kapitaleve të investuara.

Është sqaruar në këtë punim se industria minerare ishte përgjithësisht në duart e kapitalit të huaj dhe pikërisht aty, investimet ishin më të mëdha. Kjo industri në kuadrin e gjithë industrisë zotëronte 81,54% të kapitaleve. Kapitali shqiptar zinte vetëm 0,4% kundrejt 81,4% që zinte kapitali italian dhe, në një përqindje modeste edhe kapitali shqiptar i lidhur me të. Sado që kapitali shqiptar ishte kryesori në investimet në degët e tjera të përmendura në tabelë, përkatësisht në industrinë e lehtë, ushqimore, elektrike, të përpunimit të metaleve dhe të drurit, të materialeve të ndërtimit, përsëri totali i tij në shumën e kapitaleve të investuara shkonte vetëm në 15,14%. Pesë ndërmarrjet e mëdha të industrisë minerare, që zotëroheshin nga kapitali i huaj, kishin kështu pjesën e luanit në totalin e investimeve në mënyrë të padiskutueshme.

Industria minerare, për vetë natyrën e kësaj dege, kishte investuar një kapital prej 31,4% të gjithë kapitaleve të derdhura në industri, por siguronte vetëm 14% të prodhimit të përgjithshëm industrial dhe siguronte punë për vetëm 34,46% të numrit të përgjithshëm të punëtorëve.⁴

Shifrat e vitit 1938, tregojnë se ndër prodhimet kryesore të industrisë, në krye qëndronin prodhimi i naftës me rreth 108.000 tonë në vit dhe i bitumit natyror me rreth 17.000 tonë në vit, të cilat ishin në duart e kapitalit italian. Prapambetja vijonte të ishte e dukshme në ekonominë e fshatit. Vërehej një rritje e produkteve bujqësore. Megjithatë, në vitin 1938, në totalin e eksportit të produkteve bujqësoro-blegtorale, blegtoria zinte 73%, ndonëse eksportet bujqësore u rritën nga 19% në 27%.⁵

Në vitin 1938, Shqipëria kishte 2.219 km rrugë automobilistike të një standardi të pranueshëm për kohën.⁶ Në funksion të rrjetit rrugor të sipërpërmendur, nga viti 1926 deri në vitin 1938, gjatësia e përgjithshme e urave të ndërtuara llogaritej në 17,8 km.⁷

Në dispozicion të shoqërive vendase, që operonin në fushën e transportit, erdhi duke u rritur numri i mjeteve të transportit, të cilat të vitin 1938 llogariteshin të ishin rreth 500 kamionë, autobuzë, kamionçina edhe vetura.⁸

⁴ *Anuari Statistikor...*, f. 66; Theodor Kareco, *Shqipëria në rrugën e ndërtimit të bazës materiale teknike të socializmit*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Politik, 1973, f. 14.

⁵ *Po aty*.

⁶ *Anuari i realizimit të planit për gjithë sektorët e ekonomisë popullore për vitin 1949*. (Të dhëna për vitet 1938-1949.)

⁷ *Po aty*.

⁸ L. Roshi, *Zhvillimi i transportit...*, f. 17.

Këto të dhëna tregojnë që në prag të pushtimit italian, Shqipëria, edhe pse ende mbetej një vend i prapambetur, kishte hedhur disa hapa të rëndësishëm përpara përsa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.